



VIJOJNË NDESHJET NDËRMJET QARQEVE NË KUADËR TË PROGRAMIT "EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA"

Përgjatë muajit maj kanë vijuar ndeshjet ndërmjet qarqeve për dispilinën e **volejbollit dhe basketbollit, për vajza dhe djem**, në të cilat Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka marrë pjesë me qëllim ndjekjen e ecurisë së programit, por edhe për dorëzimin e medaljeve dhe kupave për skuadrat fituese. Ekipet kanë arritur në fazën gjysëmfinale pas një rrugëtimi të gjatë dhe të suksesshëm në muajin prill, ku të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e përfshirë në **Programin "Ekipet Sportive në shkolla"**, pjesë e rreth **700 skuadrave**, të cilët janë stërvitur rregullisht 3 herë në javë, kanë zhvilluar ndeshjet kualifikuese brenda qarqeve. Skuadrat fituese nga gjysëmfinalja do të vijojnë **rrugëtimin e tyre drejt Kampionatit Kombëtar**.



FAZAT E MËTEJSHME TË PROGRAMIT TË KODIMIT NË SHKOLLA

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, mori pjesë në workshop-in tre ditor midis qeverisë shqiptare, **Fondacionit Amerikano-Shqiptar për Zhvillim (AADF) dhe Bankës Botërore për shtrirjen e mëtejshme të Programit të Kodimit në Shkolla**, ku së bashku me grupin e punës u konkretizuan detajet për mbarëvajtjen dhe shtrirjen e projektit në vitet në vijim. Programi i Kodimit ofrohet aktualisht në **100 shkolla të Shqipërisë me mbështetjen e AADF**, ndërsa në fazën e dytë me mbështetje të Bankës Botërore ky program **do të shtrihet edhe në 200 shkolla të tjera**, klasat e të cilave do të përshtaten edhe për individët me aftësi të kufizuara. Në vijmësi të ndjekjes së ecurisë të Programit të Kodimit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka zhvilluar një vizitë në shkollën "1 Maji" në Berat dhe një vizitë në shkollën "Osman Myderizi" së bashku me kryetarin e Bordit të AADF-së, z. Michael Granoff dhe menaxherin e Bankës Botërore për Shqipërinë, z. Emanuel Salinas, për të monitoruar mbarëvajtjen e programit si dhe për të diskutuar për përmirësimin e mëtejshëm të tij, me mësuesit dhe nxënësit, hallkat kryesore të këtij programi.



ZBATIMI I PROGRAMIT JASHTË ORARIT MËSIMOR

Programi Jashtë Orarit Mësimor ka filluar zbatimin në fund të **muajit janar 2023 në 200 shkolla në të gjithë Shqipërinë**. Në kuadër të monitorimit të mbarëvajtjes së programit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët edhe përgjatë këtij muaji ka vijuar me zhvillimin e vizitave në shkollat ku është implementuar dhe po zbatohet Programi Jashtë Orarit Mësimor. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka zhvilluar një vizitë në shkollën "1 Maji" në Berat dhe një vizitë në shkollën "Andon Xoxa" në Fier, me qëllim monitorimin e ecurisë së përgjithshme të programit, por edhe ecurinë e secilit prej kurseve **tematike që ofrohen 2 herë në javë në fushat: pikturë; kor; teatër; zeje; bujqësi dhe mjedis; sport dhe mirëqenia; dhe teknologji**.

MBAHEN SESIONE INFORMUESE PËR HAPJEN E THIRRJES VIII TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në **konferencën ndërkombëtare të universitetit "Aleksandër Xhuvani"**, "Sfidat e gjeneratave të reja për një të ardhme të qëndrueshme", ku midis shumë arritjeve dhe rezultateve për programet, ndau me studentët dhe të pranishmit e tjerë datën e hapjes së **Thirrjes VIII të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës**. Njëkohësisht, sesionet informuese për Programin Kombëtar të Praktikave të Punës kanë vijuar përgjatë gjithë muajit në **bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë** si në universitetet publike ashtu edhe në ato private, me qëllim promovimin e programit dhe mirë informimin e studentëve për mundësinë për të zhvilluar një praktikë 3 mujore që ndikon në zhvillimin e kompetencave profesionale, akademike e personale, **duke theksuar që nga data 1 qershor deri më 30 qershor çdo i ri i moshës 21-26 vjeç**, që zotëron minimalisht një diplomë bachelor mund të aplikojë duke bashkangjitur një CV dhe letër motivimi. Gjithashtu, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, zhvilloi një takim me përfaqësues nga universitete publike dhe private, ku diskutuan rreth Programit Kombëtar të Praktikave të Punës dhe promovimit të tij tek studentët.



MBAHET EDICIONI I 80-TË I TURIT TË ÇIKLIZMIT NË SHQIPËRI

Më 22 maj, në sheshin Nënë Tereza **mbi 100 çiklistë nga 15 shtete të Europës dhe Ballkanit**, filluan **edicionin e 80-të** të Xhiros së Shqipërisë në çiklizëm, për të eksploruar **900 km** me nivele të ndryshme vështirësie. Gara filloi nga Tirana dhe do të zhvillohet në **5 etapa** duke përfshirur qytetet e Lushnjës, Elbasanit, Vlorës, Përmetit dhe për t'u mbyllur sipas traditës në Fier. **Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në hapjen e turit të çiklizmit së bashku me z. Skënder Anxhaku president i Federatës së Çiklizmit, z.Fidel Ylli, president i KOKSH, z. Endri Hoxha, zv. Ministër i MAS, z. Andi Seferi, nënkryetar i Bashkisë Tiranë dhe z. Yehoshua Kopito, kryekomisari i UÇI për turin e çiklizmit, pjesë edhe në unionin Ndërkombëtar të Çiklizmit, e cila i jep pikë skuadrave për pjesëmarrjen në olimpiadën e vitit të ardhshëm në Paris 2024.**

